

STATUTI I SHOQERISE

“ MARIO albania COSTRUZIONI” SH.P.K.

Ne baze te ligjit 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”, ne te nenshkruarit shpallim si me poshte, STATUTIN per shoqerine “**MARIO albania COSTRUZIONI**” SH.P.K.

FORMIMI I SHOQERISE

Neni 1

Formohet shoqeria e quajtur “**MARIO albania COSTRUZIONI**” SH.P.K.

(qe me poshte do te quhet “Shoqeria”) me ortake:

Z. MARJUS BREGU, I lindur ne Kavaje me datelindje 01.01.1987 me banim ne Tirane , me nr. pasaporte I70101133F , madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

SELIA E SHOQERISE

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne Tirane Njesia Bashkiake Nr.3, Rruga Zana Floqi, Nr.43. Tirane Shqiperi. Gjate ushtrimit te aktivitetit te saj, Shoqeria mund te hape dege dhe zyra perfaqesimi kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit (QKR).

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

-Aktivitet ekonomik ne fushen e ndertimit,zbatim mbikeqyrje, kolaudim, furnizim dhe vendosje, mirembajtje te ndertimeve te tjera civile dhe industriale,rikonstruksione etj. Shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tregtare industrial, mbi pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, qe do te vleresohen te nevojshme apo te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise si dhe,Tregti e pergjithshme, import-eksport dhe shperndarje e mallrave dhe produkteve te te gjitha llojeve te çdo produkti industrial, makinerive dhe pajisjeve, lendeve te para, te teknologjive te ndryshme, etj.

Neni 5

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se

ortakeve.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali i shoqerise është 100 000 leke dhe i ndarë në 1 pjese me vlere nominale prej 100 000 leke secila. Cdo ortak ka të drejtën e votës.

Kontributi i ortakeve ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:

Z. MARJUS BREGU, I lindur ne Kavaje me datelindje 01.01.1987 me banim ne Tirane , me nr. pasaporte I70101133F , madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar; e per te zoteron 1 pjese qe perfaqesojne 100% te kapitalit te shoqerise me vlere 100 000 leke

Neni 7

Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të ortakeve.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit te Shoqerive Tregtare (QKB).

Neni 9

Ortaket e shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund ta terheqin. Kjo mund te behet vetem pasi te nxirret bilanci i shoqerise per fitimin e realizuar.

Neni 10

Kuotat e cdo anetari perputhen me pjesen e tyre ne kapitalin e shoqerise. Kuotat e tij anetari i shoqerise mund t'ua ofroje te treteve. Anetaret e shoqerise kane perparesi per blerjen e kuotave perpara personave te trete jashte shoqerise. Ortaku qe deshiron te transferoje ose te shese kuotat e tij i drejton nje kerkese me shkrim Administratorit duke saktësuar cmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe te jete i njejte me ate qe do t'i ofrohet dhe nje personi te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e bleresit. Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene. Edhe e drejta e perparesise per nenshkrimin e kuotave duhet te ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Administratorit. E drejta e perparesise per nenshkrimin e kuotave eshte ne proporcion me kuotat qe zoteron secili prej ortakeve ne kete shoqeri. Administratori pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh dhe ne rast se ortakët do ti blejne keto kuota, i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij vendimin e ortakeve te tjere per te blere te gjithë ose pjeserisht kuotat e tij. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet te behen me akte

noteriale dhe nje kopje e ketij akti duhet te depozitohet ne librin e Ortakeve.

Neni 11

Emertimi i shoqerise tregtare, forma ligjore e shoqerise, numri unik i identifikimit, vendndodhja e shoqerise, emri i administratorit, duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri, nepermjet perdorimit te letres apo mjeteve elektronike, dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 12

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakeve.
- 2- Administratori.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 13

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve e cila mund te thirret nga çdo anetar i shoqerise qe perfaqeson te pakten 5% te kapitalit te shoqerise. Anetaret duhet te njoftohen me shkrese ose nepermjet postes elektronike, jo me vone se 7 dite perpara dhe ne lajmerim duhet te jete shkruar vendi, ora dhe ceshtjet e rendit te dites qe do te trajtohen ne mbledhje.

Neqoftese Asambleja nuk eshte mbledhur sipas rregullave te caktuara ajo mund te marre vendim kur çdo anetar i shoqerise eshte prezent dhe jane dakort te marrin vendime pavaresisht parregullise.

TE DREJTAT DHE KOMPETENCAT E ASAMBLESE

Neni 14

Asambleja e ortakeve mblidhet te pakten 1 here ne vit, dhe sa here eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

Asambleja e ortakeve merr vendime te vlefshme si me poshte:

- a) Ne thirrjen e pare ne pranine e ortakeve qe jane vete prezent ose te perfaqesuar nga persona te trete me prokure te posaçme dhe qe zoterojne me shume se 30 perqind te kuotave ne kapitalin e shoqerise.
- b) Ne rast se nuk sigurohet kjo shumice, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite.

Kompetencat e Asamblese:

Asambleja e ortakeve ka kompetencat e meposhteme:

- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetence te Asamblese.
- Percakton shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Te marre ne shqyrtim dhe ka te drejte te miratoje te gjitha ndryshimet e statutit.
- Ben transferimin e kuotave te te tretet.
- Realizon blerjen, shitjen dhe transferimin e pasurive te paluajtshme te shoqerise etj. dhe vendos ne lidhje me keto ceshtje;
- Vendos ne lidhje me çdo çeshtje te lidhur me pasurine e shoqerise, marrje hua, vendosje hipoteke, barre siguruese etj .
- Vendos per pjesemarrjen ne shoqeri te tjera per hapje dege, filiale, zyra perfaqesimi etj .

Neni 15

Vendimet e asamblese se Ortakeve te cilat jane marre ne nje mbledhje te thirrur ne menyre te rregullt dhe konform kontrates se themelimit, Statutit e te ligjeve jane te detyrueshme per te gjitha ortaket e tjere, edhe per ata qe nuk kane diskutuar ose nuk kane qene dakord.

Cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjetër qe nuk eshte administrator. Asnje i derguar nuk mund te perfaqesoje me shume se nje ortak.

Ne Asamblene e Ortakeve marrin pjese nese eshte e nevojshme per te dhene mendim eksperte, revizore etj.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak ose nga nje person tjetër me prokure te posaçme.

Neni 16

Marrja e vendimeve te Asamblese, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

ADMINISTRIMI

Neni 17

Shoqeria administrohet nga administratori i cili caktohet ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riperseritjeje. Ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit duke treguar me fakte demin qe i eshte shkaktuar

shoqerise nga paaftesia e tij pasi eshte dhene mendimi per kete dem edhe nga specialistet perkates.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise ua jep shprehimisht ortakeve.

Administrator i shoqerise eshte Marjus Bregu I lindur ne Kavaje me datelindje 01.01.1987 me banim ne Tirane , me nr. pasaporte I70101133F , madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Administratori zgjidhet per nje periudhe 5 (pese) vjecare me te drejte rizgjedhjeje.

Neni 18

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Ortakeve.

Neni 19

Administratori ka te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme per furnizime publike private, te ndermarre veprime gjyqesore per dhe ne emer te shoqerise, etj. Administratori mund te jape prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh. Perfaqesimi ligjor i shoqerise eshte i vlefshem per cdo veprim gjyqesor apo jashtegjyqesor.

Administratori eshte i detyruar te mbaje konform ligjit te gjitha rregjistrat e domosdoshme per aktivitetin e shoqerise. Administratori i shoqerise eshte i detyruar te mbaje inventare te rregullta nje here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me parjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Administratori eshte pergjegjes per administrimin e shoqerise dhe informon ortaket per ecurine e veprimtarise tregtare te shoqerise. Gjate veprimtarise se tij ai vepron duke marre parasysh interesat e shoqerise, duke zbatuar parimet e detyrimit te besnikerise.

MARREDHENIET E PUNES

Neni 20

Maredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet

te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 21

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i kesaj shoqerie.

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Neni 22

Kontrolli mbi veprimtarine e Administratorit, veprimtarine e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE

Neni 23

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

Neni 24

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve per mundesine e prishjes se shoqerise.

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 25

Ne rast se shoqeria priset per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

LIBRAT E SHOQERISE

Neni 26

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

- 1) Libri i Ortakeve
- 2) Libri i Mbledhjeve

- 3) Libri i vendimeve te organit administrativ
4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.
Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 27


Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Ky statut nenshkruset rregullisht nga ortaku i shoqerise

ORTAKU I SHOQERISE

"MARIO albania COSTRUZIONI" Sh.p.k.

MARJUS BREGU



Tirane me date 19.04.2022